Lezhë, më 21.02.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt 21.02.2023, në orën 13:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen e radhës të muajit Shkurt 2023, të këshillit Bashkiak Lezhë, me prezencën e ZV/kryetarit të Bashkisë z. Ermal Pacaj.

Mbledhja u hap nga kryetari i këshillit Bashkiak z. Ndue Luli i cili lexoi rendin e ditës si dhe projekt vendimin shtesë, për të cilin tha që ka nevojë për disa rregullime në aspektin formal.

Ndue Luli: Kush është dakord me rendin e ditës duke futur edhe p-vendimin shtesë me rregullimet e nevojshme.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Vazhdojmë me pikën 1 të rendit të ditës që është projekt-vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Janar 2023".

Meqë nuk ka diskutime e kalojmë në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për një shtesë në VKB nr. 120, datë 02.12.2022 "Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit për vitin 2023" dhe përdorim të fondeve të tërmetit të trashëguara nga viti 2022".

Kush e do fjalën?

Xhemal Hoxha (Drejtoria e Financës): Këto janë të sponsore, janë fonde që kanë qenë në vazhdimësi, rregullohen,

futen në sistem.

Ndue Luli: Unë kam një pyetje në lidhje me tërmetin. Kemi shumë familje me DS4, DS5 dhe nuk u jepet qeraja për vitin 2023. Si do veprohet me to? Janë raste për të cilat bashkia ka marrë përsipër ndërtimin e banesës së prishur nga tërmeti dhe akoma nuk janë ndërtuar banesat

Agostin Marku: Me lejë. Vetëm sa për ta zgjeruar pyetjen tuaj kryetar. Unë kam hasur një problem kam pyetur edhe Zyrën e Rindërtimit, edhe Zyrën e Financës. dhe përgjigja ka qenë: kanë mbaruar objektet. Por një objekt nuk quhet i përfunduar kur nuk përfundon me të gjitha elementet që ka infrastruktura e pallatit. Të gjitha përfundojnë kur merret në dorëzim, kur janë prezent edhe banorët e pallatit dhe qeraja apo detyrimi i bashkisë ndaj kryefamiljarit hiqet në atë moment. Qeraja nuk hiqet me një fjalë goje. Edhe po të ishte problem fondesh, prapë duhet një vendim, por ne nuk kemi problem fondesh sepse qeveria i ka dhënë fondet.

Ermal Pacaj: Qeraja nuk është hequr as pa vendim, as pa përfunduar pallatet. Nuk hiqen nga bonusi i qerasë me vendim këshilli. Në momentin që është përfunduar objekti, nuk jepet më bonusi i qerasë. Nuk ka asnjë rast DS4 që të ketë marrë lekë. Kemi dalë totalisht jashtë teme se p/vendimi nuk është për këtë gjë.

Historia e bonusit të qerasë është për qeverinë shqiptare pas 31 dhjetorit e ke ndaluar sepse nuk do të jepet përfundimisht. Ne kemi kërkuar këtu në këshill që një pjesë e fondit të emergjencave të kalojë për bonusin e qerasë. Bonusi i qerasë është kur je jashtë, nuk je në shtëpi. Por kur je në shtëpi dhe kërkon bonusin prapë, kjo është histori pa sens. Në lidhje me atë që tha kryetari, është bërë kërkesë dhe rikërkesë për pjesën e financimit të këtyre aplikimeve të fundit por akoma nuk kemi pasur financim, pra është bërë gjithçka praktike ligjore që financimi të vijë, po bëhen rregullime nga qeveria shqiptare, po shikohen mundësitë që të bëhet alokimi i fondeve që gjithsecili të marrë lekët që u takojnë.

Marin Suta: Kjo përgjigje është edhe për ata që janë DS1, DS2, DS3?

Ermal Pacaj: Kemi kërkuar financimin, nuk është program që e financon Bashkia e Lezhës, është program që e financon qeveria shqiptare. Ne e kemi mbyllur të gjithën si praktikë.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë në votim projektvendimin.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që votoi kundër.

Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës, që është projektvendim "Për një shtesë në VKB nr. 120,

datë 02.12.2022 "Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit për vitin 2023" si dhe përdorimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, që është projekt-vendim "Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për financimin e ofrimit të shërbimit të përkujdesit social në bashki".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Lezhë për vitin 2022".
Meqë nuk ka diskutime e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
→ Erdhi këshilltari Klejdi Hoxhaj.
Ndue Lulaj: Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e kërkesës për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek Bashkia Lezhë, të objektit "Ish Materniteti Lezhë", pasuria me nr. 3/51, 3/52, zona kadastrale 8632".
Ky projekt vendim është i shtyrë nga mbledhja e kaluar për mungesë [illegible].

Tani e kemi kuorumin. Meqë nuk ka diskutime rreth p/vendimit, e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Atëherë kalojmë te pika e shtatë e rendit të ditës, pra e miratuam për ~~te~~ shtuar, që është projekt-vendim "Për miratimin e nivelit të shpërblimeve të aktiviteteve tematike. kulturore-artistike dhe turistike".

→ Në lidhje me p/vendimin foli këshilltari Agostin Markun i cili theksoi nevojën për disa rregullime në aspektin formal të këtij p/vendimi.

– Ndue Luli: Kush është dakord me p/vendimin me rregullimet e propozuara?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Meqë nuk ka diskutime të tjera te pika "Të ndryshme", mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA GUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI